



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e Parë e rregullt e Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **28.01.2021** (e enjte) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se;
2. Raporti i Kryesutit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik 2019;
3. Aprovimi i planit të punës së Kuvendit dhe orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2021;
4. Pruarja e vendimit për shitjen e atomjeteve të vjetëra dhe të zhvlersuara të Komunës së Novobërdës;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 22.01.2021
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 29.12.2020, duke filluar në orën 12:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Zymer Zymeri, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Predrag Stojkovic, Jorgovanka Filic, Jahi Zeqiri.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 14 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raportim nga shtabi emergjent për parandalimin e Pandemisë Covid-19, në teritorin e Komunës së Novobërdës;
3. Informim nga Drejtoria e Arsimit për perfundimin e gjysëmvjetorit të parë;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?
Pasi nuk pati propozime aprovohet rendi i ditës me 12 vota për nga antarët e Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali me 12 vota për, 1 i përmbajtur dhe 1 nuk ka votuar nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Pika e dytë: Raportim nga shtabi emergjent për parandalimin e Pandemisë Covid-19, në teritorin e Komunës së Novobërdës;

Kryesuesi tha: në mbledhjet e kaluar kemi kerkuar nga këshilli emergjent që të raportoj rreth situates me pandemi covid-19, në mbledhjen e kaluar ka qenë Drejtroi i Inspeksionit për këtë mbledhje nuk është askush që të raportojë, andaj e hapi diskutimin.

Ramush Mehmeti pasi përshendeti të pranishmit tha: në këtë seanc solemne të fundvitit po shihet se nuk është askush nga ekzekutivi dhe kjo po tregon se ekzekutivi vjen në Kuvend vetem kur ka ndonjë pikë të mbulimit të buxhetit që duhet të kaloj përmes Kuvendit, perndryshe nuk kemi se çka të diskutojm më shumë.

Pasi nuk pati tjera diskutime Kryesuesi kaloj në piken e tretë.

Pika e tretë: Informim nga Drejtoria e Arsimit për perfundimin e gjysëmvjetorit të parë;

Procesverbali i Kuvendit

Kryesusi tha: të gjithë e dim se situata me pandemi e ka dëmtuar procesin mësimor, pasi që gjatë zhvillimit mësimorë më shumë është mbajtur mësimi online, si dhe gjysëmvjetori i parë ka përfunduar më herët e gjithashtu edhe gjysëmvjetori i dytë do të filloj me vones andaj ne kemi kerkuar një raport prej Drejtoris së Arsimit që të raportoj rreth gjendjes në arsim por siç duket nuk është askush që të raportoj, e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobriwoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam një qështje që e kam ngrit edhe më herët dhe kam kerkuar raport nga Drejtoria e arsimit se si i kan shpenzuar mjetet në gjysëmvjetorin e parë, është me rëndësi që të dihet si janë shpenzuar mjete në këtë Drejtori dhe ku janë shpenzuar.

Pika e katërt: Të ndryshme .

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.


Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: situata me pandemi e ka dëmtuar të gjithë qytetarët, bizneset, bujqët, të gjithë pra. Jam edhe pjesë e shtabit emergjent ku perfaqësoj Kuvendin ku edhe Kryesusi ka qenë i ftuar që të jetë pjesë e atij shtabi me të cilin kishem pas bashkarisht tju ndihmojmë dhe bashkarisht ti informojmë asambleistët. Poashtu jemi deshmitar që në seancën e kaluar pothuajse shtabi është kritikuar shumë për paqartësi në raportim por jemi deshmitar që shumë prej asamblesiteve i kanë votuar mbi 100,000€ për të ju ndarë disa organizatave të Graqanices ku është mundësia që të keqperdoren nga organizatat. Po ashtu ne kemi votuar një pako që tju dalim në ndihmë direkte qytetarëve të Komunës tonë, ku kemi diskutuar që secilin qytetarë infektuar ta ndihmojmë me një pako ushqimore në vlerë prej 50€ dhe ajo nuk është duke ndodhur për momentin. Po shpresoj që vitin e ardhshëm të kemi në mbledhje edhe Drejtorinë dhe Kryetarin të kemi një raport për punën e cila bëhet në terren. Jemi në një sall të re dhe janë kushtet më të mira por flamuri që i takon Republikës së Kosovës të vërehet më mirë pasi nuk po duket prej flamurit të bashkimit evropian.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në ora 12:30.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
z.Nebojsa Arsic



RAPORT I KRYESUESIT PËR PUNËN E KUVENDIT PËR VITIN KALENDARIK
2020

Janar 2021

Të respektuar/a

Anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Novobërdës.

Ju drejtohem si Kryesues i Kuvendit të ju raportoj për punën një-vjeçare të Kuvendit Komunal të Novobërdës, duke i përmbledhur rezultatet në çdo fushë, kështu edhe Kryesuesi i Kuvendit ka obligim që për punën vetë dhe të Kuvendit ti njoftoj ata me të cilët së bashku punon për të përmbledhur kualitetin e punës, si dhe të gjithë atyre që janë të lidhur me Kuvendin pa të cilët nuk mundet të punoj dhe realizoj qëllimet e veta: Kryetarin, Drejtorët, Ministrin kompetente e në fund edhe ata që janë më të rëndësishmit e na kanë dhënë besimin, që t'i prezentojmë në këtë organ, e ata janë qytetarët e Komunës sonë. Gjithashtu kam knaqësinë që jamë në krye të një Kuvendi multietnik, për të cilën mundë lirishtë të them që paraqet një shembull të mirë të bashkpunimit në mesë të Këshilltarëve të Komuniteteve të ndryshme ku në planin e parë është bashkëpunimi në mesë të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme dhe kanë për qëllim realizimin e kushteve më të mira të jetës për qytetarët e vetë.

Siç është e ditur Kuvendi Komunal mbështetet në aktet juridike, duke filluar nga Ligji për Vetqeverisjen Lokale, si aktin më të lartë e përmes statutit si aktin më të rëndësishëm të Kuvendit, rregullores së Kuvendit dhe akteve tjera që i aprovon Komuna. Në këtë drejtim në bazë të nenit 43.2, Ligjit për Vetqeverisje Lokale, si dhe nenit 43.2 të statutit, Kuvendi i Komunës është e obliguar t'i mbajë dhjetë mbledhje të rregullta gjatë vitit, edhe atë pesë në pjesën e parë të vitit dhe pesë në pjesën e dytë. Me knaqësi mundë të konstatoj se kemi vepruar në bazë të nenit 43.2 LVL, si dhe nenit 43.2 të statutit në kuptimin e përmbajtjes së afateve për mbajtjen e mbledhjeve.

Kuvendi Komunal ka mbajtur 8(tetë) mbledhje të rregullta dhe 2(dy) të jashtëzakonshme. Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në bazë të planit vjetor të punës.


Në mbledhjet e rregullta dhe jashtëzakonshme të mbajtura kemi aprovuar:

1. 17 vendime, dhe të gjitha janë verifikuar nga ana e Ministrisë kompetente për vetqeverisje lokale.


Kuvendi përveç mbledhjeve të rregullta të Kuvendit kemi mbajtur edhe mbledhje të rregullta të Komitetit për Politik dhe Financa ku për këtë vit i kemi mbajtu 8 (tetë) mbledhje që do të thotë se para çdo mbledhje të Kuvendit kemi shtejlluar njëher pikat në KPF-ë.

Të gjithë e dini se vitin 2020 jemi ballafaqur dhe po ballafaqohemi ende me pandemin covid-19 dhe për arsye të këtij viruesi nuk kemi pasur mundësi që ti mbajm të gjitha mbledhjet e planifikuara. Por përseri kemi arritur që pikat e rëndësishme të diskutohen në Kuvend dhe të marrim vendime.

Të nderuar antarë të Kuvendit në fundë të këti raporti deshiroj t'ju falenderohem për bashkpunimin dhe kontributin e juaj në punën e Kuvendit. Çdo propozim i juaji është i mirëseardhur, shpresoj që në këtë vit të kemi më shumë bashkpunim me Këshillin Egzekutiv dhe me angazhimin tone, me sjellje të mirfilltë mundemi të realizojmë rezultate më të mira në Kuvend ku e gjithë kjo do të reflektohet në përmisimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët, dhe shërbimet tjera si dhe ngritja e nivelit të infrastruktures Komunale.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së
Novobërdës


Nebojsa Arsic

REP. E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br 01-37
Me/Dana 18.01.2021
NOVOBËRDË - NOVO BRDO



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATË/A:	18.01.2021
PËR/ZA/TO:	Antarët e KPF-së
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic – Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2021

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politik dhe Financa për vitin 2021

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E premte	22.01.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E hënë	15.02.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E hënë	22.03.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E hënë	19.04.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E mërkurë	19.05.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E hënë	21.06.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E hënë	19.07.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E martë	24.08.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E hënë	20.09.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E hënë	18.10.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E enjte	18.11.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E hënë	20.12.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATË/A:	12.01.2021
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic – Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2021



Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E enjte	28.01.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E enjte	25.02.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E mërkurë	31.03.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E enjte	29.04.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E hënë	31.05.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E mërkurë	30.06.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E enjte	29.07.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E hënë	06.09.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E enjte	30.09.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E enjte	28.10.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E martë	30.11.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E enjte	30.12.2021	10:00	Salla e Kuvendit Komunal